



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot .

Datë _____.02.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Prodhime betoni”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Blloqe 44111600-7
- Pllaka rrugësh 44113200-7
- Podukte betoni 44114200-4
- Pllaka betoni 44114250-9
- Pllaka (ndërtimi) 44171000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,499,000 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë PA TVSH.

Në përlllogaritjen e cmimit të materialeve grupi I punës ka marrë cmimet e materialeve nga Manuali i Çmimeve të Ndërtim të vitit 2023 në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi I (parë) pika a) ,të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Nderrmarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në: nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë :

- **Licencën për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin :**
Lejë e thjeshtë mjedisore
Lejë mjedisi e tipit C

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- a) Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

Bordura betoni mëdha 100 x 25 x 15	1 copë
------------------------------------	--------

Bordura betoni vogla 80 x 20 x 8	1 copë
Pllaka betoni trotuari	Nga 1 copë për secilen formë

Mostrat duhet te dorezohen jo me vone se data dhe ora e hapjes se tenderit. Mos dorezimi i mostrave brenda afatit do te sjelle skualifikimin e operatorit pjesemarres.

Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *mostrave te mallit* është përcaktuar proporcionalisht dhe ne perputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, te LPP, si dhe nenin 40, par.6, pika a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe eshte vendosur me qellim qe Autoriteti Kontraktor te vleresoje perputhshmerine e mallrave me standartet teknike si dhe per te garantuar cilesine dhe origjinalitetin e mallrave.

➤ Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton	1	Pronësi ose me qera
2	Autovinç	1	Pronësi ose me qera

-Per mjetet e transportit duhet te paraqiten: ne rast se jane ne pronesi dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto te mjetit ku te jete e dukshme targa e mjetit.

Kur mjetet jane me qera duhet te paraqitet :kontrata e qerase e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit foto te mjetit ku te jete e dukshme targa e mjetit.

Argumentim

- 1 mjet transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton nevojitet për transportin e prodhimeve te betonit në sasi pak me të madhe ose për materiale të paketuara ose të sistemuara, për shembull paletë bordure, paletë pllaka betoni si dhe per blloqet e betonit.
- 1 autovinc nevojitet për ngarkimin ose shkarkimin e materialeve të paketuara ose të sistemuara në paleta.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.202 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”

- Disponimi i mjeteve/pajiseje të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara fazes se nenshkrimit te kontrates duhet t'i dergoje kerkese ne rruge elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për

vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s'kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

➤ **Për mjetet e mësipërme OE duhet të paraqesë Çertifikatë për transportin e mallrave.**

Argumentim: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin Neni 45 të LIGJIT Nr.8308, datë 18.3.1998 PËR TRANSPORTET RRUGORE, të përditësuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë **Çertifikatën për transportin e mallrave**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Deshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik :

Një punësim mështar prej të paktën **2 (dy)** shoferë, për periudhën **nëntor 2024-janar 2025** e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (**eSig25**).

Për shoferët duhet të paraqitet

Çertifikatën e aftësisë profesionale të lëshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Kontrata e punës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,

autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Në rastin kur mjetet janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listpagesën e shoqërisë.

Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat për Prodhime betoni që ka ndërmarrja duke u bazuar edhe në përvoja e viteve të mëparshme.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi : Prodhime betoni

Kjo kontratë ka për qëllim realizimin e furnizimit me Prodhime betoni.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Bordura betoni mëdha	ml	5,000
2	Bordura betoni vogla	ml	2,000
3	Pllaka betoni trotuari	m ²	13500
4	Blloqe betoni 20 x 20 x40	copë	1000
5	Blloqe betoni 25 x 20 x40	copë	1000

- **Forma e pllakave duhet të jenë si tek figurat me poshte për arsye të riparimeve në trotualet egzistuese:**





➤ **Bordurat e betonit te jene si me poshte:**



Bordura betoni të mëdha

Ato duhet të jenë të parapërgatitura prej betoni C16/20. Bordurat do te jene te permasave 0,15 x 0,25 x 1 m. Bordurat nuk duhet të jenë të dëmtuara dhe përmasat e tyre të jenë si të përcaktuara më lart.

Bordura betoni të vogla

Ato duhet të jenë të parapërgatitura prej betoni C16/20. Bordurat do të jenë të permasave 0.08 x 0,20 x 0,80 m. Bordurat nuk duhet të jenë të dëmtuara dhe përmasat e tyre të jenë si të përcaktuara më lart.

Pllakat e betonit

Pllakat e betonit duhet të prodhohen në fabrika të specializuara për prodhimin e tyre. Sipas specifikimeve teknike ato duhet të plotësojnë një sërë kërkesash:

Spesori (trashesia)	(10 X 20 X 6) cm dhe (20 x 20 x 6) cm
Përdorimi	Këmbësorë dhe Trafik të Lehtë
Pesha specifike	>2200 kg/m ³
Rezistenca në shtypje	>500 kg/cm ²
Përshkueshmëria nga uji	<12%
Ngjyra	Sipas Porosisë

Pllakat duhet të jenë të prodhuara me dy shtresa.

Shtresa 1—Shtresa e Poshtme, përbën 88% të volumit të pllakës dhe do jetë e prodhuar në presa me presion dhe vibrim për të garantuar Markën e Betonit dhe uniformitetin.

Betoni i prodhuar duhet të jetë i Klasës A-A, i përgatitur me inerte të fraksionuara me granulometri 0-8mm dhe çimento Portland e rezistueshme. Ngjyra në këtë shtresë mund të realizohet me porosi.

Shtresa 2—Shtresa e Sipërme, përbën 12% të volumit të pllakës (spesorit) realizohet me inerte të fraksionuara me granulometri 0-5mm, inerte të seleksionuara kuarci me granulometri 1-3mm, oksid hekuri dhe çimento Portland e rezistueshme.

Pllakat duhet të jenë të prodhuara me sipërfaqe të ashpër (për të evituar rrëshqitjen) dhe të rezistueshme ndaj ngricave.

Për sa më sipër kërkojmë nga sipërmarrësi që të dorëzojë raport analizën për pllakat që do të përdoren në trotuar.

Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *Raport analizave* është përcaktuar proporcionalisht dhe ne perputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me gjithë ndryshimet. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë perputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

Blloqet e betonit përmasat 20 x 20 x 40 cm

Blloqet me brima janë të parapërgatitura ose mund të përgatiten në kantier.

Blloqet nga një prodhues i aprovuar duhet të shoqërohen me çertifikatën e cilesie, e cila do t'i paraqitet gjatë blerjes.

- Derdhja e blloqeve duhet bërë në kallëpe në përmasat e kërkuara, si dhe të ngjeshet mirë betoni me anë të vibratorit.
- Përbërja dhe përzierja:

Përbërja e blloqeve çimento Portland e zakonshme dhe agregatët e tjerë me cilësi të aprovuar të imët dhe të ashpër me maksimumin e kokrrizës 10 mm; përzierja për blloqet që do të përdoren për mure duhet të jetë 1: 2: 4, sasia e çimentos nuk duhet të jetë më pak se 225 kg për një metër kub të betonit.
- Rezistenca e blloqeve duhet të jetë: për blloqe me boshllëqe 7 N / mm²; për blloqe solide 10 N / mm²; për blloqe me brima 5 N / mm².
- Mbas derdhjes blloqet duhen mbajtur të lagura mirë me ujë për një periudhë 10 ditore dhe nuk duhen përdorur para 30 ditëve nga dita e prodhimit.

Blloqet e betonit përmasat 25 x 20 x 40 cm

Blloqet me brima janë të parapërgatitura ose mund të përgatiten në kantier. Blloqet nga një prodhues I aprovuar duhet të shoqërohen me çertifikatën e prodhimit, e cila do t'i paraqitet gjatë blerjes.

- Derdhja e blloqeve duhet bërë në kallëpe në përmasat e kërkuara, si dhe të ngjeshet mirë betoni me anë të vibratorit.
- Përbërja dhe përzierja: Përbërja e blloqeve çimento Portland e zakonshme dhe agregatët e tjerë me cilësi të aprovuar të imët dhe të ashpër me maksimumin e kokrrizës 10 mm; përzierja për blloqet që do të përdoren për mure duhet të jetë 1: 2: 4, sasia e çimentos nuk duhet të jetë më pak se 225 kg për një metër kub të betonit.
- Rezistenca e blloqeve duhet të jetë: për blloqe me boshllëqe 7 N / mm²; për blloqe solide 10 N / mm²; për blloqe me brima 5 N / mm².
- Mbas derdhjes blloqet duhen mbajtur të lagura mirë me ujë për një periudhë 10 ditore dhe nuk duhen përdorur para 30 ditëve nga dita e prodhimit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontraktuesi duhet të furnizojë me mallra në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuara sipas standartit të kërkuar si më sipër:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Afati

12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndërmarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit. Materialet janë specifikuar në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për të qenë sa më rezistente dhe të dukshme në rrugë, gjithashtu që do të përmbushin të gjitha standartet rrugore.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT